



Prishtinë, 27 dhjetor 2013
Kodi i ZRRE-së: V_600_2013

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 14 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë,
- Dispozitat e Nenit 4 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
- Kërkesën e KOSTT SH.A për Derrogimin e dispozitave të Kodit të Rrjetit dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit të datës 11 dhjetor 2013,

në seancën e mbajtur me datë 27 dhjetor 2013, nxori këtë:

V E N D I M

I lejohet KOSTT SH.A. derrogimi në zbatimin e dispozitave të **Kodit të Rrjetit dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit** si në Shtojcë të këtij vendimi.

Arsyetim

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 11 dhjetor 2013 ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A për derrogim në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Rrjetit dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit. Pas vlerësimit të kërkesës dhe duke pasur parasysh gjendjen aktuale të Sistemit të Transmisionit, ZRRE ka parë të arsyeshme që të lejojë shtyrje të afatit në zbatimin dispozitave të Kodit të Rrjetit dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit në afatet e vendosura si në Shtojcë.

Të gjitha dispozitat tjera të Kodit të Rrjetit dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit do të mbesin në fuqi.

II Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

III Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE - së.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar